



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

P. nr. 565/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjet penale kundër të akuzuarit E.Be. nga fsh. G.K-Gj. për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 i KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP.nr.416/7 të datës 25.08.2017, në shqyrtimin publik gjyqësor, të mbajtur më datë **10.10.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj, përf. të autorizuar të dëmtuarës L.M., mbrojtësi av. R.Gj.dhe te akuzuarit E. B., me dt.**12.10.2018**, mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **E.B.**, nga fsh. G.K. Gj., data e lindjes... në fsh. G., K. Gj., i biri i R. dhe i nënës Z. e gjinisë O., shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar atë i 3 fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Bazuar ne nenin 364 par.1 nen par.1.3 te KPPK-së,

LIROHET NGA AKUZA

Sepse :

- Me datë të pavërtetuar e gjerë me dt.14.01.2016, në shtëpinë e tij në fshatin G. K-Gj., me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, me qëllim fitimi në mënyrë të paaautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike, në atë mënyrë që njehsori elektrik me nr. ... ia ka dëmtuar pllombat distributive, ashtu që ka hapur kapakun e njehsorit duke manipuluar me fazën L3, me çka ka penguar kështu regjistrimin e energjisë së shpenzuar elektrike gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar Distrikti në Gjakovë me rastin e kontrollit, me ç ‘rast të dëmtuarës K.– D.i Rr. – Distrikti në Gj. i ka shkaktuar dëm në shumë prej 1,303,42 Euro.

- me çka do të kishte kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës.

E dëmtuara K.-D. në Gj., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore -DP në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1416/2016 të dt.25.08.2017, e ka akuzuar të akuzuarin E. B. nga fshatin G., Komuna e Gj., për shkak se ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Me dt. 13.12.2017, 19.01.2018,20.02.2018, 17.04.018, 15.05.2018,07.06.2018, 05.07.2018, 23.07.2018, 02.08.2018, 07.09.2018, 20.09.2018, 10.10.2018 janë mbajtur shqyrtimet gjyqësore konform nenit 285 par. 1 të KPP-ës në të cilën janë ftuar të gjitha palët ndërsa shpallja e Aktgjykimit është caktuar me 12.10.2018.

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik të mbajtur me dt.08.05.2018,prokurori i shtetit Enis Gashi, mbeti në tërësi pranë aktakuzës PP.nr. 1416/16 të dt.23.08.2017. Në fjalën përfundimtare të mbajtur me dt. 10.10.2018, Prokurori i shtetit Ismet Tofaj, deklaroi se me provat materiale që janë në shkresat e lëndës ,dëshmisë se dëshmitarëve : V.B., M.K., B.B. dhe H.G.m është vërtetuar mjaftë se i akuzuari si person prezent sipas aktakuzës ka kryer veprën penale, ndërsa sa i përket dëshmitarit R. B., gjykatës i lë në vlerësim se një interpretim i tillë nga ana e të akuzuarit është i parëndësishëm dhe mund të jete i njëanshëm, andaj kësaj gjykate i propozoi që të akuzuarin ta shpallë përgjegjës për veprën penale ,ta dënojë sipas ligjit dhe ta obligojë në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Përf. i autorizuar i të dëmtuarës L.M. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e mbështesë në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, gjithashtu deklaroi se me të gjitha provat materiale dhe dëshmitë e dëshmitarëve të zyrtarëve të K. -it ,u vërtetua në tërësi vepra penale, po ashtu u vërtetua që përgjegjës për këtë vepër penale është këtu i akuzuari E.B. nga vet deklarata e tij pasi që babai i tij është me aftësi të kufizuara dhe gjyshi i tij ka qene i moshës se thyer dhe si rrjedhojë aftësitë psikosociale të tyre kanë qenë të kufizuara për të kryer këtë vepër penale. Gjithashtu dëshmia e dëshmitarit R. B. lë shume për të dëshiruar pasi që interpretimi për këtë gjykatë është bërë nga vet i akuzuari dhe si rrjedhojë kjo gjykatë nuk duhet ti falë besimin ,andaj nga të lartcekurat i propozoi gjykatës që këtu të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe e paraqes kërkesën pasurore juridike.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.R. Gj. në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se në bazë të provave të administruara së pari nuk është vërtetuar se është kryer vepër penale për të cilën ngarkohet i mbrojturi im. Nga deklaratat e të gjithë dëshmitarëve vërtetohet se ditën kritike nuk është bërë në formën e paraparë përshkrimi i gjendjes në njehsorin elektrik i cili ka qenë në emër të tani të ndjerit M. B. i cili që në fazën fillestare kishte kontestuar faturën e cila i është prezantuar me shumën kinse është dëmtuar pala e dëmtuar. Pastaj me provat materiale në mënyrë të sigurt është vërtetuar se këtu i mbrojturi im nuk është përgjegjës për gjendjen në njehsorin elektrik i cili ka qenë në emër të gjyshit të tij tani të ndjerit M.B. i cili në ditën kritike ka qenë prezent dhe kjo rrethanë është vërtetuar nga deklarata e të gjithë dëshmitarëve. Kisha për të potencuar deklaratën e dëshmitarit H. G. sipas të cilit këtu i mbrojturi im ka nënshkruar vetëm se ka qene prezent e jo si person përgjegjës. Dëshmitari B. B. në mënyrë decidive ka potencuar se përgjegjës për rastin konkret është M.B. Nga provat tjera me shkrim njëherë është vërtetuar së pari se njehsori ka qene në emër të ndjerit M.B., se shtëpia ka qene pronë e tani të ndjerit M.B., se i njëjti ka qenë pagues i tatimit në pronë, dhe në fund edhe kryefamiljar i bashkësisë familjare në të cilën kanë jetuar së bashku me tre djemtë dhe familjaret e tyre. Në prezencën e këtyre fakteve të vërtetuara i propozoi gjykatës që i mbrojturi im të lirohet nga përgjegjësia penale dhe akuza.

I akuzuari E.B. në fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet në përgjithësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata ka dëgjuar dëshmitarët : R.B., V.B. , M. K., B.B. dhe H. G. si dhe ka administruar provat materiale dhe atë procesverbalin nr. 1237635 të dt. 14.01.2016, Faturën – sektori i rikthimit të humbjeve nr. të dt. 15.01.2016, Faturën D..... të dt. 15.01.2016, Certifikata e vdekjes me nr. Ref. të dt. 20.02.2018 në emër të M.B. , Certifikatën nga Zyra Kadastrale në Gjakovë e dt. 28.01.2015, ku konstatohet se pronar i paluajtshmërive është M.B., Kontrata mbi dhurimin e paluajtshmërisë e noterizuar me LRP nr. me nr. Ref. ... e dt. 06.03.2015, Kundërshtimi i konsumatorit M.B.e dt. 02.02.2016 drejtuar të dëmtuarës E. – Distrikti në Gjakovë, Ankesa drejtuar Zyrës së Rregullatorit me dt. 20.05.2016 me nr. ... dhe është bërë shikimi i foto dokumentacionit të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Dëshmitari **R.B.** , gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt.17.04.2018, duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara fillimisht nga ana e mbrojtësit të akuzuarit, ka deklaruar se : Shtëpia ku jetoj është e imja, pas vdekjes së babit tim M.B. i cili në ditën kritike ishte afër moshës 90 vjeçare. Në atë shtëpi jeton edhe djali im E.. Në ditën kur kanë ardhur punëtorët e K. it në shtëpi ka qenë babai im, mandej unë me djalin tim kemi hyrë në oborr kur nga punëtorët e K.-it është kërkuar që djali im E. të nënshkruajë procesverbalin me që prindi im e as unë nuk kemi ditë me e nënshkruar. Në pyetjen e parashtruar nga ana e përfaqësuar të autorizuar të dëmtuarit, dëshmitari deklaroi se : rrymën e paguaj unë si kryefamiljarë. Në pyetjen e parashtruar nga ana e gjykatës, deklaroi se : njehsori është ndërruar nga ana e K.-ut në fund të vitit 1999, me që shtëpia ka qenë e djegur gjatë luftës.

Dëshmitari **V.B.** , gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. dt.15.05.2018, duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara fillimisht nga ana e prokurorit të shtetit , ka deklaruar se : punoj në K. që 9 vite. Me dt. 14.01.2016,kemi qenë sipas urdhëresës nga menaxheri për kontrollim të komplet lagjes për shkak të humbjeve të energjisë në atë lagje bashkë me M.K. , H.G. dhe B.B. në fsh. G. , Komuna e Gjakovës, përkatësisht në shtëpinë e M. B. . Në atë njehsor ka pasur hyrje-dalje, por njëra fazë ka qenë e manipuluar gjegjësisht L3 ka qene e kthyer prapa dhe ky manipulim e ka penguar regjistrimin e energjisë së shpenzuar. Atë ditë që e kemi konstatuar gjendjen, kolegu im B.B. e ka përpiluar procesin dhe të njëjtin me sa di unë ia ka ofruar konsumatorit për ta nënshkruar, mirëpo nuk më kujtohet se kush e ka nënshkruar atë pasi që procesin e ka përpiluar kolegu im. Në pyetjet e parashtruara nga ana e mbrojtësit të akuzuarit, dëshmitari deklaroi se : procesin mund ta nënshkruajnë edhe personat e tjerë në rast se pronari i shtëpisë nuk është prezent, *mirëpo përgjegjës është vetëm pronari i njehsorit ose shfrytëzuesi i atij njehsori*. Me rastin e kontrollit është ftuar konsumatori që të vijë tek njehsori, pasi që pa prezencën e tij nuk mund të hapet ai, mirëpo nuk më kujtohet saktësisht si figurë se kush ka qenë, por e di që ka qenë një plak i ulur në karrige. Unë nuk kam marrë pjesë në regjistrimin e pajisjeve por vetëm kam konstatuar keqpërdorimin për çka edhe kemi video incizimin nga vendi i ngjarjes. Në pyetjet e parashtruara nga ana e të akuzuarit, dëshmitari deklaroi se : nuk më kujtohet se a e kam parë të akuzuarin atë ditë dhe nuk e di se kë e kam takuar atë ditë në shtëpi, por e di se ka qenë një plak ulur në karrige. Në pyetjet e parashtruara nga ana e të autorizuarit të dëmtuarës, dëshmitari deklaroi se : nuk më kujtohet se a e ka nënshkruar procesverbalin i njëjti person që është njoftuar për gjendjen e gjetur në njehsor, ndërsa E. B. nuk më kujtohet se ka qenë atë ditë në oborr. Në pyetjet e parashtruara nga ana e gjykatës, dëshmitari deklaroi se : procesin e kam bërë unë së bashku me kolegun tim e që i qëndroj pranë atij procesi, meqenëse deri te kapaku që i mbulon hyrje-daljet dhe urat e matjes i konstatojmë ne ndërsa në brendi te njehsori ku ka të bëjë me pllombat shtetërore ato i verifikon Qendra e Kalibrimin në Prishtinë. Në fotot e prezantuara vërehet manipulimi i pllombes, mirëpo nuk mund të konstatohet koha kur është bërë dëmtimi i saj, por vetëm koha kur është vu pllomba.

Dëshmitari **M. K.**, gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt.15.05.2018, duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara fillimisht nga ana e prokurorit deklaroi se : punoj në K. – distrikti në Gjakovë në sektorin e kontrollit që 6 vite ndërsa në K. punoj që 9 vite Me dt. 14.01.2016 kemi qenë në kontroll në fsh. G., Komuna e Gjakovës, përkatësisht në shtëpinë e M.B. . Kam qenë bashkë me V. B., H.G. dhe B. B. . Pasi kemi shkuar te njehsori, kemi konstatuar se bllobbën distributive e ka pasur të dëmtuar, e pas hapjes së kapakut kemi konstatuar se L3 apo faza e tretë ka qenë në mënyrë jo të rregullt apo jo të drejtë, që furnizimi ka qenë i kyqur në të kundërtën gjë që e ka bllokuar punën e diskut të njehsorit elektrik dmth. ka penguar regjistrimin e energjisë. Prezent kemi qenë në të katërtit dhe djali këtu i akuzuari e që nuk më kujtohet emri. Të njëjtin e kemi njoftuar për gjendjen faktike mbi të gjeturat. Procesin e ka përpiluar B. B. , dhe ia ka ofruar për shikim dhe nënshkrim personit këtu duke aluduar në E.B.. Në pyetjet e parashtruara nga ana e mbrojtësit të akuzuarit, dëshmitari deklaroi se : *Sipas rregullores përgjegjësia duhet të jetë e personit në emër të cilit është njehsori por kur ai nuk është prezent atëherë merren të dhënat personale të personit përgjegjës.* Nuk e kemi bërë verifikimin e pajisjeve të shtëpisë të cekura në proces, por vetëm e kemi pyetur personin se a i kanë këto pajisje, dhe nuk i kemi fotografuar pajisjet ekzistuese. Po ashtu, pas konstatimit të keqpërdorimit të bllobbave, ato nuk i kemi ruajtur. Në pyetjet e parashtruara nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës, dëshmitari deklaroi se: Më kujtohet se këtu i akuzuari E.B. e ka nënshkruar procesin por nuk më kujtohet se a ka hezitur që t'a nënshkruajë. Në pyetjet e parashtruara nga ana e gjykatës, dëshmitari deklaroi se: pas konstatimit të gjendjes së njehsorit, është eliminuar keqpërdorimi i manipulimit. Hyrje-dalja është vendosur në mënyrë të drejtë dhe njehsori është bllobbuar me bllobba distributive. Një njehsor i ka dy bllobba distributive, por në rastin konkret në kohën e konstatimit njehsori ka pasur vetëm një bllobbë. Sa i përket asaj se kush është kompetent për t'i bërë këto vlerësime të manipulimeve të njehsorëve, pjesa e poshtme ku janë bllobbat distributive ku vendoset kyçja është kompetencë e jona ndërsa pjesa e brendshme pasi të hapet kapaku dhe bllobba shtetërore është kompetent Qendra e Kalibrimit.

Dëshmitari **H. G.**, gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 07.06.2018, duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara fillimisht nga ana e prokurorit të shtetit deklaroi se: neve na është dhënë urdhëresa që të shkojmë në fshatin G. dhe kemi filluar në fshat me rend në atë lagje të bëjmë kontroll në shtëpinë e konsumatorit M.B. , ku në bazë të faturave është konstatuar emri i konsumatorit. *Kemi biseduar me një plak rreth 60-70 vjeç dhe më kujtohet që ka qenë edhe ky djali këtu i akuzuari, të cilëve iu kemi prezantuar se kush jemi dhe për çka kemi shkuar.* Kur kemi shkuar tek njehsori, plaku morri një karrige dhe u ul, ndërsa prezent ka qenë edhe ky djali. Më pas kolegu ka filluar dhe e ka qel kapakun dhe L-3 ja ka qenë e ndërrume, që do thotë se kemi të bëjmë me manipulim të njehsorit se nuk regjistron çka shpenzon. Procesin e ka përpiluar kolegu im B.B. dhe kam dëgjuar të njëjtin i cili gjatë kontrollit ka biseduar me E. si person prezent që ishte. Ai e ka ftuar E. dhe ka kërkuar nga ai që vetëm të ia jap emrin pasi që ishte prezent. Nuk më kujtohet nëse plaku dhe E. kanë thënë diçka, pasi që unë më nuk jam interesuar pasi që procesin e ka përpiluar kolegu im B. . Nga përvoja ime e di se në procesverbal duhet të konstatohet shfrytëzuesi i njehsorit sepse në rast se dikush është me qira ai deklarohet se është qiramarrës. *Në rastin konkret, meqë ishte prezent E., është kërkuar nga ai që ta nënshkruajë procesverbalin, që të mos mundohet plaku.* Me rastin e kontrollit unë kam qenë bashkë me M. K. V.B. dhe B. B. . V. dhe M. e kanë bërë kontrollimin e njehsorit, ndërsa unë dhe B. kemi qenë pas dmth. . pasi është bërë kontrolli dhe është konstatuar gjendja. Në pyetjet e parashtruara nga ana e mbrojtësit të akuzuarit, dëshmitari deklaroi se : Kur është bërë verifikimi, njehsori nuk ka pasur bllobba. Ato i kemi vendosur në pasi e kemi kryer punën dhe nuk e di nëse është bërë verifikimi i pajisjeve elektrike ditën kritike, pasi siç e thash edhe më herët procesverbalin e ka përpiluar kolegu im, pasi unë jam larguar nga aty. Në pyetjet e parashtruara nga ana e e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarit, dëshmitari deklaroi se : unë kam qenë prezent vetëm kur e kam nënshkruar procesverbalin dhe nuk e di se a janë njoftuar konsumatorët për konstatimet.

Ndërsa në pyetjen se “meqë nuk e keni munduar plakun me nënshkru, a i bie kjo se ai nuk ka qenë në gjendje as me e keqpërdor”, për të cilën pyetje pati vërejte mbrojtësi i të akuzuarit, dëshmitari deklaroi se nuk mund të përgjigjet në këtë pyetje. Në pyetjet e parashtruara nga ana e gjykatës, dëshmitari deklaroi se : konstatimet e cekura në procesverbal i kam konstatuar edhe unë, por procesin e ka përpiluar kolegu im. Me sa e di unë, njehsorin e ka hapur M. K. dhe pasi e lexoj procesverbalin deklaroi se bllobat kanë qenë të dëmtuara. Njehsori ka qenë i vendosur në ballë të shtëpisë – kati i I-rë i shtëpisë.

Dëshmitari **B.B.**, gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 07.06.2018, duke u përgjigjur në pyetjet e parashtruara fillimisht nga ana e prokurorit deklaroi se : unë jam përpilues i procesverbalit në të cilin kemi qenë në kontroll të shtëpia e M. B. nga fsh. G.. Kolegët V. B. dhe M. K. e kanë hapur kapakun dhe kanë vërejtur se ka parregullsi dhe e kam përpiluar procesin. Unë punoj si zyrtar i K.-it që 13 vite, ndërsa në përpilimin e procesverbalit kam përvojë që 6 vite. Sipas Rregullores së K.-it, një procesverbal duhet të përmbajë të dhënat e njehsorit, parregullsitë apo rregullsitë e njehsorit që i jep kolegu për atë njehsor dhe instalim. Kjo do të thotë, që atë ditë përpilimi i procesverbalit është bërë nga diktimi i kolegëve pasi V. B. dhe M. K. e kanë bërë kontrollin e njehsorit dhe ata i kanë vërejtur parregullsitë në procesverbal. Nuk më kujtohet sa persona i kemi parë atë ditë tek konsumatori, por më kujtohet që kam folur me E. B. të cilit i kemi thënë : *“A ki mundësi me na nënshkruar këtë proces pasi që je prezent me këtë rast, pasi plaku nuk mundet ta nënshkruajë”*. Dhe i njëjti e ka nënshkruar procesin. *Sipas faturës, M. ishte shfrytëzues i njehsorit elektrik, ndërsa E. ishte prezent me rastin e kontrollit.* Sipas meje, ishte hera e parë që u kontrollua ajo shtëpi, ndërsa më pas nuk e di ka qenë dikush tjetër pasi nuk jam kompetent ta di. Në ditën kritike, V. dhe M. kanë hyrë të parët meqenëse ata e bëjnë kontrollin e njehsorit dhe nuk e di se më kë kanë biseduar sepse unë dhe H. kemi shkuar më pas ,pasi është verifikuar keqpërdorimi dhe unë kam kontaktuar me E. sepse ka qenë më i ri,. Në pyetjet e parashtruara nga ana e mbrojtësit të akuzuarit, dëshmitari deklaroi se : Urdhëresat për kontroll ipen me shkrim vazhdimisht dhe se mund të gjendet urdhëresa për fshatin. Në pyetjet e parashtruara nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës, dëshmitari deklaroi se: Unë e kam pyetur plakun se a mund të nënshkruajë, por nuk ka mund meqenëse iu kanë dridhur duart. Nuk mund të deklarohej në lidhje me atë se a ka mundur plaku t’a keqpërdor rrymën ose jo. Në pyetjet e parashtruara nga ana e gjykatës, dëshmitari deklaroi se : *Sipas faturës e vërtetojmë se a është prezent M. dhe a është shtëpia e tij dhe a jeton ai aty dhe më pas e vazhdojmë procedurën.* Nëse nuk është e M. e kërkojmë shfrytëzuesin se kush është në atë shtëpi si shfrytëzues, e nëse nuk na paraqitet ne e bëjmë konstatimin në procesverbal, konstatimin e gjendjes së njehsorit dhe të instalimit.

Nga leximi i procesverbalit i K. -it, mbi gjendjen e njehsorit elektrik me nr..... , të dt.14.01.2016,në emër konsumatorit M. B. , gjykata ka konstatuar në këtë procesverbal se njehsori elektrik e ka pllombën distributive të dëmtuar dhe kur është hap kapaku i njehsorit është vërejtur hyrja-dalja e L3 e ndryshuar që do të thotë kjo fazë L3 nuk ka regjistruar shpenzimin e harxhuar, i merret fuqia pasive elektrike që kanë qenë në këtë fazë.

Nga leximi i faturës së K. -it me nr.... i dt. 15.01.2016, gjykata ka konstatuar se është bërë llogaritja dhe faturimi i shpenzimeve të pa autorizuar.

Nga leximi i faturës së K. -it , me numër D.... të dt. 15.01.2016, gjykata ka konstatuar se me anë të kësaj fature është përcaktuar rikthimi i humbjeve nga ana e K. -it.

Nga shikimi i foto dokumentacionit nga nr.3 deri në nr.7, Gjykata ka konstatuar se në këto fotografi shihet njehsori elektrik me nr.... të cilat fotografi janë bërë nga punëtorët e K. -it gjatë kontrollit të njehsorit elektrik.

Nga leximi i ekstraktit - Certifikatës së vdekjes me nr. Ref. ... të dt. 20.02.2018, gjykata ka konstatuar se konsumatori M. B. nga fsh. G. , ka vdekur me dt. 02.07.2017.

Nga leximi i Kundërshtimit në procesverbalin nr. ... të dt. 14.01.2016, Gjykata ka konstatuar se konsumatori M.B. nga fsh. G. , me dt. 02.02.2016, iu ka drejtuar të dëmtuarës K. – Distrikti në Gjakovë, me të cilin ka kundërshtuar në tërësi konstatimet në procesverbalin mbi gjendjen e njehsorit, gjë që vërtetohet edhe nga fletë dorëzimi i dt.02.02.2016.

Nga leximi i Ankesës drejtuar Zyrës së Rregullatorit me dt. 20.05.2016, me nr. ..., Gjykata ka konstatuar se konsumatori M.B. si pronar pronar i shtëpisë dhe konsumator i njehsorit i është drejtuar edhe Zyrës së Rregullatorit në Prishtinë, duke i kundërshtuar veprimet dhe konstatimet e punëtorëve të K. -it me rastin e kontrollimit të njehsorit me dt.14.01.2016..

Nga Certifikatën e Zyrës Kadastrale në Gjakovë e dt. 28.01.2015, gjykata ka konstatuar se e tërë paligjshmëria sipas kësaj certifikate ishte e regjistruar në emër të M. S. B. nga fsh. G., Komuna e Gj. mirëpo me datën 06.03.2015 Gjykata ka konstatuar është përpiluar akti noterial mbi kontratën e dhurimit të paluajtshmërive në mes të dhuratëdhënësit M.s. B. dhe dhuratëmarrësve e cila kontratë është e noterizuar tek noteri A.r Z. S. në Gjakovë me LRP nr.... me nr. Ref. ... e dt. 06.03.2015.

I akuzuari E. B. , gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë ndërsa në mbrojtje ka deklaruar se unë nuk e ndiej veten fajtor meqenëse isha duke punuar me babin tim në një shaktë të kanalizimit duke e pastruar, kur ka ardhur një veturë e K. -it me katër persona , kanë pyetur se ku është shtëpia e babit të Z. (Z. është i ndjeri axha im që ka punuar në K.). Më kanë pyetur se a ka mundësi me hy e me e lexua njehsorin, unë iu kam thënë se po por unë kam ndenjur me babin duke punuar në shaktë. Dy persona kanë vazhduar rrugën në drejtim të shtëpisë ku ishte i vendosur njehsori, ku pas pak kam hyrë në shtëpi dhe i kam parë duke biseduar me gjyshin i cili ishte ulur në një karrige . Aty i kanë thënë gjyshit se a ka mundësi me e nënshkruar se jemi ardhur për lexim të njehsorit , pasi që gjyshi nuk din shkrim e lexim ka kërkuar të vë gisht në proces . Meqenëse punëtorët e K.-it, nuk kishin pajisje për me vu gisht , njëri nga punëtorët na ka thënë se ska problem koka këtu djali e le të nënshkruan pasi është prezent. Procesverbali nuk ishte i mbushur pasi nuk ka pasur të konstatuar asgjë por pas pamundësisë për ta nënshkruar gjyshi ma kanë ofruar mu .Dy punëtorët e K-it që ishin unë nuk i kam njohur por pasi kanë dëshmuar në gjykatë tani e di se kanë qenë M.K. dhe B.B. por në atë kohë kryefamiljarë ka qenë gjyshi i cili edhe e ka bërë pagesën e pas vdekjes është baba im R.B. Me gjyshin në atë shtëpi kanë jetuar në bashkësi familjare tre djemta e tij : R. me familje, tani i ndjeri Z.B. me familje dhe gruaja e axhës H. B. bashkë me familje meqenëse axha H. ka vdekur ndërsa pas vdekjes së gjyshit pronar i shtëpisë është babai tim R. B.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor i ka nxjerr të gjitha provat e nevojshme dhe pas administrimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari E.B. nuk është kryes i veprës penale që i ngarkohet me aktakuzë, meqenëse nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale andaj konform nenit 364 par.1 nën par.1.3 të KPP-ës, gjykata ndaj të akuzuarit E. B. , për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, ka marr aktgjykim lirues.

Me administrimin e e provave gjykata ka vërtetuar si jo kontestues faktin se me dt. 14.01.2016, kontrollorët e K. –it fillimisht kishin shkuar në fshatin G., Komuna e Gj. për kontroll në shtëpinë e M. B. . Punëtorët e K.-it gjegjësisht V.B. dhe M. K. kanë konstatuar se njehsori elektrik

me nr. ... i ka të dëmtuar pllombën distributive dhe kur është hap kapaku i njehsorit është vërejtur hyrja dalja e L3 të ndryshuar që do të thotë kjo fazë L3 nuk ka regjistruar shpenzimin e harxhuar , i merret fuqia e pajisjeve elektrike që kanë qenë në këtë fazë elektrike, ekzistojnë fotot kanë edhe tjera., ku ka qenë prezent edhe konsumatori M.B. . Pasi që kanë konstatuar keqpërdorimin e njehsorit punëtori B. B. ka përpiluar procesverbalin nr.... të dt.14.01.2016,mbi gjendjen e njehsorit me nr. nr. ... , pasi është bërë nga diktimi i punëtorëve si V.B. dhe M.K. që e kanë bërë kontrollin e njehsorit . Procesverbalin e kanë nënshkruar të gjithë punëtorët e K.-it por edhe i akuzuari E. B. si person prezent , e jo konsumatori M.B. e cila rrethanë u vërtetua edhe nga deklaratat e dëshmitarëve si : M. K. i cili gjatë dëshmisë së tij deklaroi se : Sipas rregullores përgjegjësia duhet të jetë e personit në emër të cilit është njehsori por kur ai nuk është prezent atëherë merren të dhënat personale të personit përgjegjës,. Po ashtu dëshmitari H.G. i cili gjatë dëshmisë së tij ka deklaruar se : Nga përvoja ime e di se në procesverbal duhet të konstatohet shfrytëzuesi i njehsorit sepse në rast se dikush është me qira ai deklarohet se është qiramarrës. Në rastin konkret, meqë ishte prezent E. , është kërkuar nga ai që ta nënshkruajë procesverbalin, që të mos mundohet plaku, e posaçërisht dëshmitari B. B. i cili në dëshminë e tij ka deklaruar se : më kujtohet që kam folur me E. B. të cilit i kemi thënë: “A ki mundësi me na nënshkruar këtë proces pasi që je prezent me këtë rast, pasi plaku nuk mundet ta nënshkruajë dhe i njëjti e ka nënshkruar procesin edhe pse sipas faturës, M. ishte shfrytëzues i njehsorit elektrik, ndërsa E. ishte prezent me rastin e kontrollit.

Në këtë drejtim Gjykata pasi ka vlerësuar deklaratat e dëshmitarëve V.B. ,M.K. , H.G. dhe B.B. , të njëjtëve iu ka falur besimin ngase të njëjtat janë në harmoni me njëra tjetrën dhe janë bindëse dhe janë në harmoni edhe me mbrojtjen e të akuzuarit të cilës gjykata ia ka falur besimin meqenëse të njëjtit kanë deklaruar se konsumatori M.B. në emër të cilit është njehsori ka qenë i pranishëm mirëpo procesverbali i është dhënë këtu të akuzuarit për nënshkrim me arsyetim se i njëjti mos të mundohet për shkak të moshës së tij apo pamundësisë që ta nënshkruaj edhe pse sipas rregullores përgjegjësia duhet të jetë e personit në emër të cilit është njehsori apo shfrytëzuesit në rast se është me qira . Këtë rrethanë Gjykata e vërtetoi edhe nga kundërshtimi i paraqitur nga konsumatori M.B. nga fsh. G. me dt.02.02.2016 kundër procesverbalit mbi gjendjen e njehsorit me nr.... të datës 14.01.2016 drejtuar K-it si dhe nga Ankesa e tij si konsumator drejtuar Zyrës së Rregullatorit për Energjinë në Prishtinë me dt. 20.05.2016 .Edhe nga mbrojtja e të akuzuarit E. B. del se kur ka ardhur një veturë e K-it më katër persona , kanë pyetur se ku është shtëpia e babit të Z. ? meqenëse i ndjeri axha im që ka punuar në K. dhe më kanë pyetur se a ka mundësi me hy e me e lexua njehsorin, unë iu kam thënë se po por unë kam ndenjtur me babin duke punuar në shaktë. Dy persona kanë vazhduar rrugën në drejtim të shtëpisë ku ishte i vendosur njehsori , ku pas pak kam hyrë në shtëpi dhe i kam parë duke biseduar me gjyshin M. i cili ishte ulur në një karrige . Aty punëtorët i kanë thënë gjyshit se a ka mundësi me e nënshkruar se jemi ardhur për lexim të njehsorit , pasi që gjyshi nuk din shkrim e lexim ka kërkuar të vë gisht në proces dhe njëri nga punëtorët ka thënë se ska problem koka këtu ky djali e le të nënshkruan pasi është prezent.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarës L.M.të dhëna në fjalën përfundimtare se me të gjitha provat materiale dhe dëshmitë e dëshmitarëve të zyrtarëve të K.-it ,u vërtetua në tërësi vepra penale, po ashtu u vërtetua që përgjegjës për këtë veprë penale është këtu i akuzuari E.B. nga vet deklarata e tij pasi që babai i tij është me aftësi te kufizuara dhe gjyshi i tij ka qenë i moshës se thyer dhe si rrjedhojë aftësitë psikosociale të tyre kanë qenë të kufizuara për të kryer këtë veprë penale, por gjykata konsideron se një deklaram i tillë është i pabazuar nga fakti se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale në shtëpinë e tij në fsh. G. K-Gjakovë , vetëm se ka qenë prezent e në prani të konsumatorit gjyshit të tij M.B. në emër të cilit ka qenë e regjistruar jo vetëm shtëpia ku ka qenë i vendosur njehsori por e tërë paluajtshmeria gjë e cila është vërtetuar nga Certifikatën nga Zyra Kadastrale në Gjakovë e dt. 28.01.2015, ku konstatohet se pronar i paluajtshmërive është M.B. , Kontrata mbi dhurimin e

paluajtshmërisë e noterizuar me LRP nr. ... me nr. Ref. ... e dt. 06.03.2015 e po ashtu nga fakti se nga provat e administruara nuk është arritur të vërtetohet data e saktë e kryerjes së veprës penale të pretenduar nga prokuroria dhe duke u mbështetur në nenin 9 të KPRK-ës , që është përcaktuar se “*vepra penale konsiderohet se është kryer kur kryesi ka vepruar apo ka qenë i obliguar të veproj, pa marr parasysh kohën kur është shkaktuar pasoja* “ nga se vetë zyrtari – punëtori V.B. në cilësinë e dëshmitarit ka deklaruar se nuk mund të konstatohet se kur është bërë dëmtimi i bllobës apo manipulimi në njehsor por mund të konstatohet vetëm kur është vënë blloba .

Duke pas parasysh të gjitha këto rrethana , faktet e shqyrtuara dhe me provat e vërtetuara Gjykata morri aktgjykim liruës për faktin se aktakuza ka mbetur në nivelin e dyshimit të arsyeshëm dhe jo të bazuar mirë në prova të artikulueshme dhe të besueshme se i akuzuari të ketë kryer veprën penale për të cilën ngarkohet , pasi që në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka theksuar se me provat materiale qe janë në shkresat e lëndës ,dëshmisë se dëshmitarëve : V.B. , M. K. , B. B.dhe H. G. është vërtetuar mjaftë se i akuzuari si person prezent sipas aktakuzës ka kryer veprën penale, por nga të gjitha provat e administruara gjykata nuk ka mundur të vërtetoj faktin se i akuzuari si person prezent të jetë përgjegjës për veprën penale të përshkruar në dispozitiv të aktakuzës , andaj gjykata në mungesë të provave duke u bazuar në nenin 364 par.1 pika 1.3 të KPP-ës të akuzuarin E. B. e ka liruar nga akuza për veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës.

Vendimi qe e dëmtuara te udhëzohet ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463 parg.3 te KPP-së.

Vendimi qe shpenzimet e procedurës penale ,te bien ne barrën e mjeteve buxhetore te gjykatës është marr bazuar ne nenin 454 par.1 te KPP-së .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi konform nenit 364 par.1 nën. par.1.3 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P.nr. 565/17 të dt. 12.10.2018.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë në afatin prej **15 ditësh**,nga dita e marrjes se tij në dorëzim , Gjykatës se Apelit në Prishtinë . Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykatë.